



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës së Prishtinës Agim Kuleta, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Emilija Redžepi, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 20.02.2020 Nr.020-160
Zyrtaret përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e për monitorim të komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Prishtinës	
Lloji i aktit:	<input type="checkbox"/> Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. 01-464/01-33114/20 për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahim Gashit, Fatmir Gashit dhe Gafurr Gashit

I miratuar më datë: 10.02.2020

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 12.02.2020

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Shpend Ahmeti, gradonačelnik opštine Priština Agim Kuleta, predsedavajući Skupštine opštine Priština	
Cc:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini	
Preko:	Emilija Redžepi, ministarka MALSa Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i nadgledanje opština, MALS	Dana: 20.02.2020. Br. 020-160
Odgovorni službenici:		
1. Potvrđeno od:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za nadgledanje opština	
2. Izrađeno od:	Vjosa Ahmetaj, službenica za nadgledanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta Opštine Priština	
Vrsta akta:	<input type="checkbox"/> Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br. 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, Pravnom odeljenju i nadgledanje opština Ministarstva za administraciju lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Odluka Skupštine opštine br.01-464/01-33114/20 za razmenu opštinske nepokretne imovine sa nepokretnom imovinom u vlasništvu Rrahima Gashija, Fatmira Gashija i Gafurra Gashija.
Usvojena dana: 10.02.2020. godine.
Dostavljena MALS-u za razmatranje dana: 12.02.2020. godine.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt sa proceduralnog aspekta u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvoditi pravni efekat. Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe nenit 6 të Ligjit nr. 06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunes së Prishtinës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-320/2019, të Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.02.2020

HYRES-UTAZNA-INCOMING
REPUBLIC OF KOSOVA
GENERALI E KOSOVES VLADA-KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
2020
Data
Datum
Date
12.02.2020
Niveli organizativ Nr./Lëndës Sitojca Vlera
-VI- 010-460

V E N D I M

- I. MIRATOHET propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahim Gashit, Fatmir Gashit dhe Gafurr Gashit.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 01668-4, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-01668-4, Zona kadastrale Çagllavicë - Prishtinë, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është pjesë e parcelës kadastrale nr. 01684-4, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01684-4, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Rrahim Gashit, Fatmir Gashit dhe Gafurr Gashit.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues "Prishtina e Re"- Zona Qendër.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VIII. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-464/01-33114/20, më 10.02.2020

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Na osnovu odredba člana 12, stav 12.2, slovo d, Zakona br. 03/L-040, o lokalnoj samoupravi ("Službeni List Republike Kosova", br. 28/15, juni 2008), član 24, stav 1, 2 i člana 6 Zakona br. 06/L-092, za davanje na korišćenje i izmenu nepokretne imovine Opštine ("Službeni Liste Republike Kosova", br. 10/03, april 2019), a, i člana 34.1, slovo d, Statuta Opštine Priština, 01. br. 110-391, donesena na Skupština Opštine Priština, na sednici održanoj dana 10.02.2020,

Stamp: **Opština Priština**
Kosovo
Date: 12.02.2020
Number: 01-020-160

ODLUKA

- I. **USVAJA SE** pedolog Predsednika Opštine za izmenu nepokretne imovine opštine sa nepokretnom imovinom u vlasništvu Rrahim Gaši, Fatmir Gaši i Gafurr Gaši.
- II. Nepokretna imovina opštine koja će se dati za izmenu, ima ove karakteristike: deo katastralne parcele br. 01668-4, sertifikat imovine, br. P-71914075-01668-4, Katastarska zona Čaglavica - Priština, dok nepokretna imovina koja se uzima iz ove izmene je deo katastarske parcele br. 01684-4, Sertifikat imovine, br. P-71914059-01684-4, Katastarska zona Priština, u vlasništvu Rrahim Gaši, Fatmir Gaši dhe Gafurr Gaši.
- III. Izmena nepokretne imovine je izvršena zato što ne postoje druge opštinske pogodne parcele za realizaciju regulativnog Plana "Nova Priština"- Zona Centar.
- IV. Pre javne objavljivanja odluke, biće izvršena kvalifikovana procena tržišne vrednosti nepokretne imovine Opštine i procena privatne svojine, gde će se odrediti tačne površine za izmenu.
- V. Način i uslovi razmene nepokretne imovine biće određeni ugovorom, koja se vezuje i potpisuje između Predsednika Opštine i vlasnika katastarske parcele koja će se izmeniti.
- VI. Nepokretne imovine opštine koja će se izmeniti, opisane u tačku II ove odluke, treba evidentirati u katastarskim knjigama Opštine.
- VII. Za sprovođenje ove odluke stara se: Predsednik Opštine, Direkcija za Imovinu i Direkcija za Katastar Opštine Prištine.


VIII. Sastavni deo ove odluke su :

- grafičke skice,
- kopije plana i
- certifikat katastarske jedinice.

IX. Ova odluka stupa na snagu 15 dana nakon registracije u Kancelariju protokola Ministarstva Lokalne Samouprave i objavljivanja na službenim jezicima na veb stranici Opštine.

SKUPŠTINA OPŠTINA PRIŠTINE
01-464/01-33114/20, dana 10.02.2020

PREDSEDAVAJUĆI SKUPŠTINE
Agim Kuleta





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS

Kryetari i Komunës

13-463/03-246907/19, dt. 08.10.2019

Në bazë të dispozitave të nenit 58, shkronja **h** e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15 qershor 2008), nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019) dhe të nenit 52, shkronja **h** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, nr. 05, nr. 350/02-25323/19, dt.28.08.2019, në cilësi të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, më 15.10.2019, i

PROPOZOJ

- I. Kuvendit të Komunës, miratimin e Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahim Gashit, Fatmir Gashit dhe Gafurr Gashit.
- II. Propozimi i cekur në pikën I të këtij propozimi, nënkupton këmbimin e:
 1. Sipërfaqes prej 359 m² e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës së Prishtinës, pjesë e parcelës kadastrale nr. 1668-4, ZK Çagllavicë, Prishtinë, me:
 2. Pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahim Gashit, Fatmir Gashit dhe Gafurr Gashit, pjesa e parcelës nr. 1684-4, ZK Prishtinë, me sipërfaqe për këmbim prej 359m².
- III. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private.
- IV. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të këtyre parcelave do të rregullohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesve të parcelave të parapara për t’u këmbyer.
- V. Pjesë përbërëse e këtij propozimi është edhe skica gjeodezike.
- VI. Ky propozim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit.

A r s y e t i m

Drejtoria e Urbanizmit në bazë të Vendimit për përcaktimin e kushteve ndërtimore, 05. nr. 350/02-25323/19, dt.28.08.2019, ka dhënë Pëlqimin për këmbimin e pjesëve të parcelave kadastrale nr. 1668-4, ZK Çagllavicë, Prishtinë, në pronësi të Komunës së Prishtinës, dhe pjesës së parcelës nr. 1684-4, ZK Prishtinë, në pronësi të Rrahim Gashit, Fatmir Gashit dhe Gafurr Gashit, pjesa e parcelës me nr. 1668-4, ZK Çagllavicë, Prishtinë, që gjendet në kuadër të bllokut urban “B-2” të tërësisë “B” të Planit rregullues “Prishtina e Re” - Zona Qendër, në Prishtinë, dhe pjesa e parcelës nr. 1684-4, ZK Prishtinë, me destinim “hapësirë publike e planifikuar”.

Propozimi për iniciimin e këmbimit të pjesëve të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues “Prishtina e Re” - Zona Qendër në Prishtinë, Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore 05. nr. 350/02-25323/19, dt. 28.08.2019.

Pjesa e parcelës nr.1668-4, ZK Çagllavicë, Prishtinë, shtrihet në zonë të planifikuar për ndërtim të lartë, ndërsa parcela nr.1684-4, ZK Prishtinë shtrihet në infrastrukturë publike të planifikuar rrugë.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private, është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.

U dërgohet:

- Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe
- Qendrës për shërbime me qytetarë.

Kryetari i Komunës

Shpend Ahmeti



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 44, 57 & 140 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-03, dt.21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt. 20.02.2008 dhe nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrative të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, si dhe duke vendosur sipas kërkesës, 05nr.350/03 – 110860/19 dt.15.05.2019, për rishqyrtimin e Vendimit 05nr.350/02 – 25323/19 dt.02.05.2019, mbi refuzimin e kërkesës për caktimin e kushteve ndërtimore, 05nr.350/02 – 25323/19 dt.05.02.2019, të bashkë pronarëve, Rrahim, Fatmir dhe Gafurr Gashi nga Prishtina dhe Investitori "Delta Invest"sh.p.k. nga Fushë Kosova, rr."Nëna Tereze", nr.114, me certifikatë të regjistrimit të biznesit 71315614 dhe me përfaqësues Lorik Xhaferi nga Prishtina, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste – Objekti "1", "2", "3" & Kulla "1", "2", në kuadër të Bllokut urban "B-2", Tërësia "B" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër" në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit në procedurë të rregullt administrative me datë 28.08.2019, merr këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIMIN E VENDIMIT 05NR.350/02 – 25323/19 DT.02.05.2019, MBI REFUZIMIN E KËRKESËS PËR KUSHTE NDËRTIMORE, SHFUQIZIMIN E VENDIMIT DHE CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

- I. Miratohet kërkesa 05nr.350/03 – 110860/19 dt.15.05.2019, e bashkë pronarëve, Rrahim, Fatmir dhe Gafurr Gashi nga Prishtina dhe Investitori "Delta Invest"sh.p.k. nga Fushë Kosova, rr."Nëna Tereze",nr.114, me certifikatë të regjistrimit të biznesit 71315614, përfaqësuar nga Lorik Xhaferi, për rishqyrtimin e Vendimit 05nr.350/02 – 25323/19 dt.02.05.2019, mbi refuzimin e kërkesës për kushte ndërtimore, 05nr.350/02 – 25323/19 dt.05.02.2019, dhe caktimin e kushteve ndërtimore.
- II. Shfuqizohet Vendimi 05nr.350/02 – 25323/19 dt.02.05.2019, mbi refuzimin e kërkesës 05nr.350/02 – 25323/19 dt.05.02.2019, për caktimin e kushteve ndërtimore, të bashkë pronarëve, Rrahim, Fatmir dhe Gafurr Gashi nga Prishtina dhe Investitori "Delta Invest"sh.p.k. nga Fushë Kosova, rr."Nëna Tereze",nr.114, me Certifikatë të regjistrimit të biznesit 71315614, përfaqësuar nga Lorik Xhaferi, dhe kërkesa për caktimin e kushteve ndërtimore mirët në rishqyrtim.
- III. I caktohen kushtet ndërtimore bashkë pronarëve, Rrahim, Fatmir dhe Gafurr Gashi nga Prishtina dhe Investitori "Delta Invest"sh.p.k. nga Fushë Kosova, rr."Nëna Tereze",nr.114, sipas kërkesës për kushte ndërtimore, 05nr.350/02 – 25323/19 dt.05.02.2019, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e kompleks me ndërtesë shumë banesore & afariste – Objekti "1", "2", "3" & Kulla "1", "2", në kuadër të Bllokut urban "B-2", Tërësia "B" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale,nr.1686-1 ZK Prishtinë me trajtim edhe të parcelës kadastrale nr.1684-4 ZK Prishtinë, përmes këmbimit me parcelën kadastrale nr.1668-4 ZK Çagllavicë me pronar / poseduese P.SH. Rugët - KK Prishtinë, dhe shpronësimit/kompensimit me sipërfaqe ndërtimore, sipas projekt propozimit / Plani i situacionit - "zgjidhjes urbane" të prezantuar.
- IV. Lokacioni i kompleksit të parcelave për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet në kuadër të Bllokut urban "B-2" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër" në Prishtinë,

miratuar me Vendimin e KK Prishtinë 01 nr.035 - 186861 dt.02.10.2013, dhe sipas këtij plani kjo zonë është e destinuar "Banim i mesëm", si dhe në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, miratuar me Vendimin e KK Prishtinë, 01nr.035-181427 dt. 24.09.2013;

Pronarët dhe investitori për kriteret, parametrat urban dhe kushtet e ndërtimit, janë informuar përmes "Informim nga Plani Rregullues Prishtina e Re – Zona Qendër" me referencë nr.2248 dt.05.06.2019, të lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm të Komunës së Prishtinës.

V. Gjendja ekzistuese e lokacionit/parcelave të lartcekura sipas gjendjes, kadastrale, pronësore, faktike & planifikimit urban është:

- Numri, sipërfaqja, pronari & klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, janë:
 - nr.1686-1; S=5805m²; Rrahim, Fatmir dhe Gafurr Gashi; "Arë e klasit 4";
 - nr.1684-4; S=1456m²; Rrahim, Fatmir dhe Gafurr Gashi; "Arë e klasit 4";
 - Totali i parcelave private: S=7261m².
 - nr.1668-4; S=359m²; P.SH. Rrugët - KK Prishtinë; "Rrugë";
 - Totali i parcelave private & komunale: S=7641m².
- E drejta pronësore - juridike e parcelave të lartcekura, është private dhe komunale, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale dhe evidencës kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale nr.1686-1 ZK Prishtina përfshihen tri ndërtesa individuale ndërtesa individuale banimore dhe ndihmese, me etazhitet nga P+0 dhe P+1, kurse parcela nr.1684-4 ZK Prishtinë është e zbrazët – e pa ndërtuara;
- Terreni ka pjerrtësi /disnivel nga drejtimi veri – lindje kah drejtimi jug - perëndim, me nivelin ~7.50m;
- Qasja ekzistues e parcelës kadastrale në 1686-1 ZK Prishtinë, përmes rrugëve lokale të asfaltuar e cila rrugë njëherë është edhe rrugë e planifikuar e planit rregullues urban;
- Kompleksi me ndërtesë shumë banesore & afariste është si vazhdimësi e komplekseve të realizuara sipas kriterëve të planit rregullues urban dhe leje ndërtimi;
- Brenda pjesës së Bllokut urban "B-2" Tërësia "B" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër" në Prishtinë, përfshihet edhe pjesa e parcelës kadastrale nr.545-0 ZK Çagllavicë me S=63m² me pronar / posedues Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës;
- Në hapësirën e përfshirë në diametër prej 50 m' ka ndërtesa ekzistuese si: ndërtesa shumë banesore & afariste, Kompleksi "Pallati i drejtësisë", shtëpi individuale banimore, etj;

VI. Kushtet e ndërtimit për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar në kuadër të Parcelës ndërtimore në kuadër të pjesës së Bllokut urban "B-2", Tërësia "B" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër" në Prishtinë, përcaktohen bazuar në parametrat, kriteret urban, kushtet për ndërtim për realizimin - ndërtimin e kompleksi me ndërtesë shumë banesore & afariste dhe hapësira përcjellëse, janë:

- Organizimi & qasja në kompleks, pozicionimi, gabaritet, etazhiteti i ndërtesave, raporti i ndërtesave me vijën rregulluese & ndërtimore, si dhe me distanca nga kufiri i parcelës, rrugët dhe vend parkingjet e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit - "zgjidhja urbane" bashkangjitur vendimit kushteve ndërtimore;
- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelës ndërtimore të Bllokut urban "B-2", Tërësia "B" planifikohet të ndërtohet Kompleksi me ndërtesa shumë banesore & afariste, me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:

Kompleks me ndërtesa shumë banesore & afariste – Objekti, "1", "2", "3" & Kulla "1", "2"

- Objekti "1" - S=3914.40m² / 3096.20m², mbi tokë + 818.20m², nën tokë /, Etazhitet: -B + S + P + 7,
- Objekti "2" - S=4642m² / 3673.40m², mbi tokë + 968.60m², nën tokë /, Etazhitet: -B + S + P + 6,
- Objekti "3" - S=6559.40m² / 5006.70m², mbi tokë + 1552.70m², nën tokë /, Etazhitet: -B + S + P + 7 + Ph,
- Kulla "1" - S=6047.80m² / 4783.05m², mbi tokë + 1264.75m², nën tokë /, Etazhitet: -B + S + P + 7 + Ph,

11/11/2018
11:11:11

Kulla "2" - S=6248.35m² / 5223.66m², mbi tokë + 1021.70m², nën tokë /

Etazhitet: -B + S + P + 7 + Ph,

Totali S= 27408.25m² / 21783m², mbi tokë + 5625.96m², nën tokë /

- o Pjesët & parcelat kadastrale për realizimin e kompleksi me ndërtesa shumë banesore & afariste, të trajtuara brenda vijës rregulluese, janë:

- nr.1686-1; S=5805m²; / pronë private /
- nr.1684-4; S=0.00m²; / pronë private /
- nr.1668-4; S=359m²; / prone e P.SH. Rrugët – KK Prishtinë /

Sipërfaqe totale: S=6164m²;

- o Pjesët e parcelës kadastrale për realizimin e kompleksi me ndërtesa shumë banesore & afariste, të trajtuara jashtë vijës rregulluese, përmes këmbimit dhe kompensimit / shpronësimit me sipërfaqe ndërtimore janë:

- nr.1686-1; S=0.00m²;
- nr.1684-4; S=1456m²; / pronë private /
- nr.1668-4; S=0.00m²;

Sipërfaqe e trajtuar: S=1456m²;

- o Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesave të kompleksit, të jetë ndërtim shumë banesor & afarizëm në raport 70%(banim) / 30%(afarizëm), si dhe me hapësira përcjellëse, si: këmbim teknike, depo dhe hapësira garazhesh etj. (sipas projekt propozimit);
- o Etazhitei maksimal për Bllokun urban "B-2", Tërësia "B" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", është IV + VIII etazhe mbi tokë (sipas projekt propozimit etazhitei maksimal është, nga B+S+P+6 gjerë B+S+P+7+Ph);
- o Koefficienti i shfrytëzimit i parcelës ndërtimore / parcelave kadastrale të bashkuara sipas grupeve-fazave në kompleks (ISHP), për vendosjen e ndërtesave në bazë-gabarit të përdheseve ose suteranit, lejohet max.40%, kurse për etazhet mbi nivelin e katit të parë të ndërtesave të kompleksit ose mbi lartësinë 9m', është max.25%:
Përdhese ose suteran, max.40%, dhe kjo sipërfaqe është:
S=5805 x 0.4=2322m² / për pronën private /
S=359 x 0.4=143.60m² / për prone e P.SH. Rrugët – KK Prishtinë /
S=2444.30m² /sipas projekt propozimit/
- o Koefficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore (ISHPN), sipas grupeve-fazave, për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit është max.60%, bazuar në paragrafin II. pika 1. të Vendimit 01nr.031 – 185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është:
S=5805 x 0.6=3483m² / për pronën private sipas planit rregullues /
S=359 x 0.6=215.40m² / për prone e P.SH. Rrugët – KK Prishtinë /
S=3695.10m² /sipas projekt propozimit/
- o Në kuadër të kompleksit të planifikohen edhe hapësira me sipërfaqe gjelbëruese (ISGJ) min.40%, me gjelbërim të lartë & të ultë, dhe të organizuara për sport & rekreacion. Sipërfaqet gjelbëruese, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, për kompleksin është:
S=5805 x 0.4=2322m² /për pronën private /
S=380 x 0.4=143.60m² /për prone e P.SH. Rrugët – KK Prishtinë /
S=2465.60m² /sipas projekt propozimit/
- o Koefficienti i ndërtimit (ISPN) sipas Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër" është max. 3.0 , dhe trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: 100% për etazhet mbi kuotën ±0.00, 50% për etazhet me vëllim mbi 51% apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - *suteran*, dhe 0% për etazhet e nëntokës – *bodrum*, dhe kjo sipërfaqe është:
S=5805 x 3.0=17415m² /për pronën private /
S=359 x 3.0=1077m² /për prone e P.SH. Rrugët – KK Prishtinë /
S=21783m² /sipas projekt propozimit duke llogaritur edhe kompensimin – shpronësimi /
- o Me aplikimin e Vendimit 01nr.400-660 dt. 26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për kompensimin e pronës private planifikuar për interes publik me sipërfaqe ndërtimore, sipërfaqja e parcelës jashtë vijës rregulluese(deri në 20% të parcelës ndërtimore) mund të

Faqe 3 prej 13
Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizimit
Adresa: rr. "Radovan Zagoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: +383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizim@prishtine.org.net

7/11. Niveli
do të rreth
Group 7/11

kompensohet, dhe sipas kalkulimit kjo sipërfaqe e shprehur në përqindje (%) është $S=1097/6164 \times 100=17.79\%$, andaj edhe e tëra sipërfaqja mund të trajtohet, gjegjësisht sipërfaqja prej, $S=1097m^2$. Sipërfaqja e lartë cekur e kalkuluar me koeficient ndërtimi, përcakton sipërfaqen ndërtimore prej, $S=1097 \times 3.0=3291m^2$.

Bazuar në kalkulimet e lartë cekura sipërfaqja totale e lejuar ndërtimore për ndërtesat shumë banesore & afariste – Objekti "1", "2", "3" & Kulla "1", "2" do të jetë:
 $S=17416 + 1077 + 3291=21783m^2$

- o Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, protokolluar me numrin 01nr.031-185481 dt. 14.08.2016, për shkak të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- o Bazuar në kriteret e planit rregullues, distanca minimale ballore në mes të ndërtesave të jetë $1.0 \times H$ (ku H, është lartësia mbi tokë e ndërtesës), kurse e ndërtesës me kufirin e parcelës fqinje $0.5 \times H$ ose min. 7m, ku distanca prej 7.0 m vlen edhe në rastet kur në atë fasadë nuk ka hapje – ndriçim primar për hapësirat e banimit (dhoma dite, fjetje, pune, tryezari, korridore të banesave, etj);
Distanca në mes të ndërtesave (shumë banesore apo afariste) të fasadat e kombinuara (njëra ndërtesë fasadë ballore, kurse tjetra ndërtesë fasadë anësore) lejohet distanca $0.6 \times H$;
- o Etazhitefi maksimal i lejuar në Bllokun urban "B-2" është max. $V + IX$ kurse sipas projekt propozimit është P+10 , bazuar në Vendimit 01nr.400-660 dt. 26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për kompensimin e pronës private planifikuar për interes publik;
- o Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt. 14.08.2016, protokolluar me numrin 01nr.031-185481, për arsye të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e termoizolimit në fasadat e ndërtesës, nuk do të përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore (ISHN), e as në kalkulimin për taksën e lejes ndërtimore;
- o Ngritja e nivelit të përdheses nga niveli i terrenit- trotuarit të ndërtesës, lejohet max. 1.2 m;
- o Bazuar në projekt propozimin e prezantuar, afarizmi është planifikuar te Objekti, "1", "2" dhe "3" në etazhet e suteranit, dhe pjesërisht në përdhese te Objekti "1" dhe "2", si dhe Kulla "1" dhe "2" nga suterani gjerë në katin 4, kurse banimi është në etazhet tjera-mbi katin e katërt;
- o Dalje / mos daljet me konzollë mbi etazhet e përdheses në këtë bllok urban nga ana e rrugëve publike – vija ndërtimore, nuk janë të lejuara;
- o Bazuar në kriteret e planit rregullues për Bllokun urban "B-2", për tipologjinë "D", raporti i sipërfaqeve ndërtimore, banim / afarizëm është 70%(banim) / 30%(afarizëm);
- o Qasjet në komplekse të jenë nga rrugët e planifikuar e planit rregullues urban sipas planit të situacionit / zgjidhjes urbane të prezantuar dhe miratuar nga kjo drejtori;
- o Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe vend-parkimet e jashtme, shtigjet, trotuaret kënde të lojërave për fëmijë, terrene sportive, mobiluar urban, etj.;
- o Për çdo njësi banesore-rezidenciale të planifikohet 1.2 vend-parkime/një njësi banesore, kurse për pjesët afariste të ndërtesës, varësisht prej destinimit, të parashihen vend-parkimet, për çdo 1000m²/40 vend-parkime për shitore, banka, posta dhe të ngjashme, për çdo 1000m²/20 vend-parkime për administratë, për çdo 1000m²/50 vend-parkime për ndërtesa hoteliere, për çdo 1000m²/30 vend-parkime për ndërtesa kulturore dhe përmbajtje publike, si dhe për salla poli funksionale 20 ulëse / 1 vend-parkim;
- o Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për grumbullimin dhe vendosjen e mbeturinave;
- o Si dhe aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane & arkitektonike të përcaktuara në kriteret & parametrat urban të Plani Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim".
- o Arkitektura-dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth;

VII. Ndarja / parcelimi i parcelës kadastrale nr.1668-4 ZK Çagllavicë dhe nr.1684-4 ZK Prishtinë, do të realizohet sipas Manualit e ndarjes punuar nga kompania gjeodezike e licencuar "Geo-Group"sh.p.k. nga Prishtina.

Kjo drejtori përmes këtij paragrafi jep PËLQIM për ndarjen e parcelës kadastrale të lartcekura, sipas Manualit i ndarjes punuar nga gjeometri i licencuar. Procedura e ndarjes / parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Kjo procedurë të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronari & investitorit, duke u bazuar edhe në, Plani i situacionit - "zgjidhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori, dhe Manuali i ndarjes punuar nga kompania gjeodezike "Geo-Group"sh.p.k. nga Prishtina me numër të licencës nr.52, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

Kjo procedurë do të realizohet në Drejtorin e Kadastrit të Komunës së Prishtinës.

VIII. Këmbimi i pjesës së parcelës kadastrale nr.1668-4 ZK Çagllavicë, me pronar / poseduese P.SH. Rrugët - KK Prishtinë dhe me sipërfaqe S=359m², me pjesën e parcelës kadastrale, nr.1684-4 ZK Prishtinë me pronar/posedues Rrahim, Fatmir dhe Gafurr Gashi, gjithë ashtu me sipërfaqe prej S=359m².

Këmbimi i lartë ceku do të realizohet bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" e miratuar nga kjo drejtori dhe manualit të ndarjes punuar nga gjeometri i licencuar, sipas Ligjit 06/I-092 dt.07.03.2019, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Andaj, Drejtoria e Urbanizmit jep PËLQIM për këmbimin e pjesëve të parcelave kadastrale të lartcekura, sipas manualit të këmbimit punuar nga gjeometri i licencuar. Procedura e këmbimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf dhe Manualit të ndarjes punuar nga kompania gjeodezike "Geo-Group"sh.p.k. nga Prishtina me numër të licencës nr.52, të cilët do të shërbejë si bazë për reflektimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Mos realizimi i kësaj procedura obligon Drejtorin e Urbanizmit, të anuloi vendimin e kushteve ndërtimore dhe të niërtat ti rishikoi.

IX. Bashkimi i pjesës dhe parcelës kadastrale, nr.1684-1 ZK Prishtinë dhe nr.1668-4 ZK Çagllavicë, do të realizohet sipas Parcelës ndërtimore, pas realizimit të procedurës së këmbimit të përcaktuar në paragrafin VIII. të këtij vendimi, bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", Situacionit të parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga PRR "Prishtina e Re – Zona Qendër" në Prishtinë, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manuali i bashkimit punuar nga kompania gjeodezike e licencuar.

Andaj, drejtoria jep PËLQIM për bashkimin e parcelave të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane" & Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga PRR " Prishtina e Re – Zona Qendër" në Prishtinë, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe manualit për bashkim.

Procedura e bashkimit do të realizohet pas realizimit të procedurave të paragrafit VII. & VIII. të vendimit të kushteve ndërtimore dhe bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e cila do të shërbejë si bazë për regjistrimin në operetën kadastrale, të këtyre ndryshimeve.

Bashkimi të realizohet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, me kërkesë të pronarëve & investitorit, si dhe bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues " Prishtina e Re – Zona Qendër" në Prishtinë, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualit për bashkimin punuar nga kompania gjeodezike e licencuar "Geo-Group"sh.p.k. nga Prishtina me numër të licencës 52, e të cilët janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

X. Kompensimi / shpronësimi me sipërfaqe ndërtimore i pjesës së parcelës, nr.1684-4 me S=1097m² e përfshirë në hapësira publike të planifikuara – rrugë & gjelbërim të realizohet si më poshtë:

Me aplikimin e Vendimit 01nr.400-660 dt. 26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për kompensimin e pronës private planifikuar për interes publik me sipërfaqe ndërtimore, sipërfaqja

e parcelës jashtë vijës rregullore - parcelës ndërtimore (deri në 20%) mund të kompensohet dhe sipas kalkulimit kjo sipërfaqe e shprehur në përqindje (%) është $S = 109778134 \times 100 = 17.79\%$, andaj, sipas kësaj e tere sipërfaqja mund të trajtohet/kompensohet, gjegjësisht sipërfaqja prej $S = 1076m^2$. Andaj, sipërfaqja e lartë cekur e kalkuluar me koeficient ndërtimi, përcakton sipërfaqen ndërtimore prej, $S = 1097 \times 3.0 = 3291m^2$.

Kjo drejtori përmes këtij paragrafi të vendimit të kushteve ndërtimore jep PËLQIMIN për kompensimin / shpronësimin me sipërfaqe ndërtimore të pjesës së mbetur të parcelës kadastrale nr. 1684-4 ZK Prishtinë. Kjo procedurë e kompensimit / shpronësimin me sipërfaqe ndërtimore do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të pronarit të parcelës dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës të Komunës së Prishtinës.

Trajtimi definitiv i sipërfaqeve për kompensim / shpronësim me sipërfaqe ndërtimore të mirëet pas realizimit të procedurës të përshkruar në paragrafin VII. të dispozitivit të këtij vendimi;

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafit, nga bashkëpronarët & investitori, për arsye të ndryshme, obligon Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë sipërfaqet ndërtimore të ndërtesës shumë banesore & afariste, të përcaktuara me këtë vendim të kushteve ndërtimore.

XI. Kycja në infrastrukturë - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kycje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në orio-foto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (desinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).

Kycja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kycje nga "Termokos" - Ngrohtorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

XII. Dokumentacioni ndërtimor - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimin për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Rregullores mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi", të MMPH nr. 0/2016 dt. 04.11.2016, "Udhëzimit Administrativ MMPH-së 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor", bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;

1/2017
1/2017
1/2017

- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e teknikishterisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritarëve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shirteje, mobilierin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zjarri;
- Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;

XIII. Dokumentacioni ndërtimor për Masat e mbrojtëse nga zjarri të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

